



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

Nr.138 Prot

Durrës, më datë 09.08.2023

URDHËR

“Për shtyrjen e afatit të shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me procedurat për 1 (një) pozicion “Shef Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, 1 (një) pozicion “Shef Sektori i Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun e Media, si dhe 1 (një) pozicion Kryesekretar”

Sot, më datë 09.08.2023, bazuar në nenin 37/b të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), Vendimit Nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësore,

KONSTATOJ

Me vendimin Nr. 35 Prot, datë 24.07.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është vendosur: “1. Shpalljen e procedurës për lëvizjen paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, si vijon: - 1 (një) pozicion “Shef Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; - 1 (një) pozicion “Shef Sektori i Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun e Media; - 1 (një) pozicion “Kryesekretar”. 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. 3. Një kopje e këtij vendimi të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës dhe t’i komunikohet KLGJ-së dhe çdo gjykatë së bashku me njoftimin për shpallje bashkëlidhur këtij vendimi”.

Në vijim të zbatimit të këtij vendimi, nga ana e Kancelares së Gjykatës, pranë zyrës së Zv/Kryetarit të Gjykatës është depozituar shkresa informacion me Nr. 392 PB, datë 09.08.2023, me anë të së cilës është bërë me dije se në datë 08.08.2023 ka përfunduar afati i paraqitjes së dokumentacionit për lëvizje paralele, për tre pozicionet e shpallura. Për pozicionin Shef Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ka dorëzuar dokumentet si kandidatë Znj. Marsida Arkaxhiu. Nga verifikimi i kryer sipas vendimit Nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ është konstatuar se Znj. Arkaxhiu i plotëson kushtet paraprake për këtë pozicion. Për sa i përket dy pozicioneve të tjera, nuk ka paraqitur dokumentacion asnjë kandidat. Nga ana e Kancelares është deklaruar e mbyllur kjo procedurë dhe është kaluar në fillimin e procedurës së ngritjes në detyrë, për këto dy pozicione. Për vendin e Kryesekretares kanë paraqitur dokumentacion dy kandidat, ndërsa afati maksimal për këto dy vende është deri në datë 15.08.2023. Në këtë shkresë është bërë me dije se muaj Gusht

është muaj pushimesh për gjyqtaret dhe administratën dhe nga ana e Kancelares nuk është e mundur ndjekja e këtyre procedurave, nga data 10-25.08.2023.

Në rrethanat si më sipër, vlerësoj se është vendi që të procedohet me shtyrjen e afatit të shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me këto tre vende, pasi nga ana e Zv/Kryetarit të Gjykatës është miratuar leja për Kancelaren për periudhën 10.08.2023-25.08.2023 (Urdhër Nr. 136, datë 04.08.2023). Vlerësoj të theksoj se afatet e përcaktuara nga vendimi i Këshilli i Gjykatës, sa i përket paraqitjes së dokumenteve për aplikim në tre pozicionet e lira nuk cenohet, ndërsa shqyrtimi i dokumentacionit do të bëhet në mbledhjen e parë të Këshillit të kësaj Gjykate.

Sa më sipër,

URDHËROJ

1. Shtyrjen e afatit të shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me procedurat për 1 (një) pozicion "Shef Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, 1 (një) pozicion "Shef Sektori i Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun e Media, si dhe 1 (një) pozicion Kryesekretar.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e tij t'i komunikohet Kancelares, Kandidatëve dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Një kopje e këtij urdhri të afishohet në faqen zyrtare të gjykatës.

ZV/KRYETAR

PAULLIN GERA

